



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. ~~1554~~ / prot.

13

Tiranë, më 21.6.2024

VENDIM

Nr. 42, datë 21.6.2024

PËR

PËR PRANIMIN DHE PUBLIKIMIN E SPECIFIKIMEVE TË CERTIFIKIMIT TË EASA, PËR PËRDORIM PËR ZBATIMIN E PJESËS 26 TË URDHËRIT TË MINISTRIT NR. 61, DATË 18.03.2024.

Në mbështetje të neni 14, pika (ë), të Ligj Nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil” dhe në zbatim të pikës 26.30 dhe Pjesës 26 të Urdhrit të Ministrit Nr. 61, datë 18.03.2024, për miratimin e rregullores “Për specifikimet shtesë të vlefshmërisë ajrore për një tip të caktuar të operimeve”,

V E N D O S A

1. Pranimin e Specifikimeve të Certifikimit të EASA dhe Materialeve përkatëse Udhëzuese për specifikimet shtesë të vlefshmërisë ajrore *GM to CS-26 Issue 4*.
2. Për specifikimet shtesë të vlefshmërisë ajrore do të përdoren CS të EASA të pranuar me këtë vendim dhe të publikuara në adresën <https://www.easa.europa.eu/en/regulations/initial-airworthiness>.
3. Deri në përkthimin e tyre në gjuhën shqipe, këto materiale do të përdoren në gjuhën angleze sipas variantit të publikuar në faqen zyrtare të EASA.
4. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit, në veçanti Sektori Vlefshmërisë Ajrore, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
5. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit të marrë masa për njoftimin apo publikimin për aplikantët apo operatorët ekzistues të pranimit të CS të mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

